



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
**MINISTRIA E FINANCAVE
DHE EKONOMISË**

Postuar më: 10/05/2021

Rritet mbështetja buxhetore për blerjen e vaksinave anti covid.

Nga pikëpamja buxhetore, angazhimi i Qeverisë Shqiptare në procesin e vaksinimit dhe alokimeve të nevojshme për të plotësuar cdo nevojë për mbrojtjen e qytetarëve shqiptarë ka qënë në nivelet me optimale gjatë këtyre dy viteve.

Prej vitit 2020, kur ende luftohej me pandeminë me masa reaguese, parandaluese dhe mbështetëse, vaksinimi si zgjidhja e vetme dhe më afatgjatë ka qënë një prioritet Qeverisë.

Cdo nevojë në sistemin shëndetësor është përballuar me sukses përmes buxhetit të shtetit dhe mbështetjes së gjerë të partnerëve tanë kryesorë ndërkombëtarë.

Për vitin 2020 në buxhetin e Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale janë alokuar 25 milion euro fonde shtesë dhe 5 milion euro grante të cilat janë përdorur për përballimin e epidemisë së Covid 19.

Kështu, Qeveria Shqiptare ka siguruar:

Sigurimin e mjeteve të mbrojtjes personale për stafet mjekësore.

Investimet në rritjen e kapacitetit të sistemit shëndetësor

Vaksinën e gripit falas për 368 mijë qytetarë të grupeve të rrezikuara duke e 4-fishuar atë në krahasim me një vit më parë.

Një flotë e re prej 36 autoambulancash të reja për Urgjencën Kombëtare për të siguruar shërbime më të shpejta dhe shërbime në banesë për rastet e trajtimit të qytetarëve me Covid.

Rritje dhe forcim të kapaciteteve spitalore me pajisje mjekësore për fuqizimin e spitaleve Covid dhe spitaleve rajonale për përballimin e pandemisë nga pajisjet respiratore, monitore, pajisje radiologjike.

Sigurimin e terapive të mjekimit me medikamentet sipas protokolleve të shërbimeve spitalore të njëjta me vendet e tjera pa asnjë mungesë.

Shpërblimet e bonusit prej 1000 euro dhe 500 euro për stafet në vijën e parë të luftës anti COVID.

Paketa e rimbursimit për trajtimin ambulator në banesë të personave të infektuar me SARS-COV-2. Paketa e rimbursimit për trajtimin e pacientëve të testuar pozitiv me Sars-Cov-2 përbëhet nga dy skema trajtimi, me rimbursim 100% nga shteti.

Në aktin e fundit normativ të buxhetit 2020 Qeveria alokoi një shtesë të fondeve për Shëndetësinë dhe Mbrojtjen Sociale me 1.4 miliardë lekë, nga të cilat:

- ☐ 400 milionë lekë për spitalet në shërbim të situatës së COVID 19;
- ☐ 1 Miliardë lekë shkojnë për Skemën e Ndhmës Ekonomike & Paaftësisë, në funksion të përdorimit nga pasojat sociale të Pandemisë Covid-19.

Në vitin 2020 nga ana e Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale është kryer gjithashtu pagesa prej 430 milion lekë për kuotën në bazë të marrëveshjes me COVAX.

Ndërkohë për vitin 2021, nga Fondi Rezerve i Buxhetit të Shtetit për vitin 2021, në muajin Janar, janë akorduar fonde në vlerën 430 milion lekë, për parapagimin e dozave të vaksinës Pfizer.

Së bashku me të gjitha përpjekjet e suksesshme për negociata dhe përfshirjen në mekanizmat ndërkombëtarë, Shqipëria filloi me datë 11 Janar 2021 vaksinimin antiCovid me vaksinën Pfizer – BioNTech.

Së fundmi në 2 Akte Normative, Qeveria Shqiptare ka bërë të mundur rialokimin e buxhetit të nevojshëm drejt Fondit Rezervë për mbulimin e nevojave aktuale dhe të ardhme për vakcina, konkretisht si më poshtë:

Së pari, një ndryshim në shpenzimet buxhetore, një rialokim midis dy nën-zërave të Fondit Rezervë 2021, dhe përkatësisht:

Shtimin me 1 miliardë lekë të Fondit Rezervë të Këshillit të Ministrave – Me qëllim përballimin e shpenzimeve të blerjes së vaksinave gjatë vitit 2021, si edhe të shpenzimeve të tjera eventuale të Qeverisë që lidhen me Pandeminë Covid19;

Pakësimin me 1 miliardë lekë të rezervës për Studime e Projektme – në kuadër të riorientimit të prioritetëve të Qeverisë gjatë situatës pandemike Covid-19 për vitin 2021, projekte të cilat parashikohet të shtyhen për 6-mujorin e dytë 2021.

Kjo nevojë ka qënë e lidhur ngushtësisht me përfitimin e një grupi të vaksinave nëpërmjet akteve normative dhe VKM-ve për furnizimin e Republikës së Shqipërisë me vaksinën e inaktivizuar kundër Covid-19 (Vero Cell) Coronavac, të krijuar nga Sinovac Life Science dhe të prodhuar në Republikën Popullore të Kinës”.

Së dyti, ndryshimet në zërin e të ardhurave dhe shpenzimeve të Buxhetit për vitin 2021:

Shtesën me 2 miliardë lekë në Fondin Rezervë të Këshillit të Ministrave – Me qëllim përballimin e shpenzimeve të blerjes së vaksinave gjatë vitit 2021, si edhe të shpenzimeve të tjera eventuale të qeverisë që lidhen me pandeminë Covid19;

Shtesën në të njëjtën masë, pra 2 miliardë lekë të të ardhurave tatimore, si rrjedhojë e analizës pozitive të të ardhurave në buxhet.

Qeveria Shqiptare mbetet e gatshme të sigurojë dhe të marrë në vazhdimësi masat e nevojshme për mbulimin e plotë të planit të vaksinimit masiv të popullatës.

Ndërrhyrjetë fundit në buxhet nuk prekin parametrat kyc makro-fiskalë dhe parashikimet për stabilitetin e tyre.

Indikatorët si deficitin buxhetor dhe borxhi publik mbeten të pandryshuara dhe në përmirësim drejt një konsolidimi fiskal afatmesëm. Kështu, “Shqipëria Buzëqesh” do të shndërrohet edhe në sloganin e përbashkët të një ekonomie që rimëkëmbet shpejt dhe qëndrueshëm.